



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.267/2012

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit: _____ nga Mitrovica kundër të paditurit _____ nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. _____ nga Mitrovica, baza e kontestit: vërtetimin e pronësisë në vështrim të nenit 148 te LPK-se me datë: 16.01.2014 në seancë gjyqësore ne prani të palëve ndërgjyqëse mori këtë:

A K T G J Y K I M
- në bazë të pohimit -

- **VËRTETOHET** se paditësi _____ nga _____ rr _____ nr _____ është pronar ne bazë të kontratës mbi shitblerjen I banesës e cila gjendet ne ish UL.P. tani lagjja _____, banesa ne katin e VII te banimit me sipërfaqe prej 84.9m2, e ndërtuar ne ngastrën katastrale P-ZK Mitrovicë.
- **OBLIGOHET** i padituri qe paditësit tja lejoj regjistrimin e banesës ne fjalë ne regjistrat e drejtorisë përkatëse- pranë Komunës se Mitrovicës

A r s y e t i m

Paditësi me datë: 24.10.2012 ka parashtruar në gjykatë padi për vërtetim pronësie kundër të paditurit.

Gjykata me datë: 16.01.2014 ka caktuar seancën kryesore në këtë çështje, ku pala paditëse në seancë deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, me një precizim sa i përket katit të banesës.

I autorizuari i të paditurit në seancë e pohoi padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi, ndërsa hjeku dorë nga e drejta në ankesë.

Gjykata pasi analizoi provat që gjenden në shkresat e lëndës, të deklaratat e paditësit dhe të autorizuarit të të paditurës konsideroi se deklaramet e të njëjtëve nuk janë në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së.

Gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm në seancë mori aktgjykim në bazë të pohimit konform nenit 148 të LPK-së pasi baza e kërkespadi së vërtetohej edhe nga provat tjera që ishin në lëndë, po ashtu vendosi që ky aktgjykim bëhet i plotëfuqishëm ditën e nxjerrjes së të njëjtit pasi palët hjekën dorë nga e drejta në ankesë.

Andaj duke u bazuar në nenit 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE,
C.nr. 267/2012 Me dt.16.01.2014.**

**GJYQTARI
Faton Ademi**



UDHËZIM JURIDIK: Ky aktgjykim bëhet i plotëfuqishëm ditën e nxjerrjes, pasi palët kanë hjek dorë nga e drejta në ankesë